

Punëtori tematike në Kërçovë

Më 18 qershor të vitit 2008 në Kërçovë u mbajt punëtori në temë “Roli i Komisionit për marrëdhënie mes bashkësive dhe kontributi i saj në i tij në avancimin e besimit dhe tolerancës ndëretnike në Kërçovë”.

Në punëtorinë morën pjesë gjithsej 19 përfaqësues nga institucionet dhe organizatat joqeveritare, mes tyre 3 anëtarë të Komisionit për marrëdhënie mes bashkësive në Kërçovë, 7 anëtarë të Këshillit Komunal të Kërçovës, 1 përfaqësues nga Komuna e Kërçovës dhe 9 përfaqësues nga organizata joqeveritare të cilët punojnë me çështjen e pakicave.

Në punëtori u diskutua për shkaqet e bashkëpunimit jo të mjaftueshëm dhe komunikimit mes këshilltarëve dhe anëtarëve të komisionit për marrëdhënie mes bashkësive, komunës dhe organizatave joqeveritare, si dhe tejkalimin e këtyre problemeve. Pos kësaj u bisedua edhe për dispozitat në Ligjin e vetëqeverisjes lokale dhe nevojën për definim më preciz të kompetencave të komisionit për marrëdhënie mes bashkësive.

U qartësuan rolet e komisionit për marrëdhënie mes bashkësive, këshillit të komunës dhe organizatave joqeveritare, u bisedua për nevojën e një bashkëpunimi më të afërt mes komisionit dhe këshillit në zgjidhjen e çështjeve kyçe rreth jetesës multi-etnike në Kërçovë, si edhe për nevojën për takime më të shpeshta të komisionit dhe organizatave joqeveritare me qëllim të adresimit të problemeve të bashkësive dhe zgjidhjen e tyre institucionale.

Punëtorinë tematike e organizoi Fondacioni Institut Shoqëri e Hapur – Maqedoni në bashkëpunim me zyrën lokale të projektit në Kërçovë (Qendra për zhvillimin e bashkësisë Kërçovë, ish Qendra për përkrahje të OJQ-ve në Kërçovë).

Si rezultat i punëtorisë tematike në Kërçovë u përmirësua bashkëpunimi mes Komisionit për marrëdhënie mes bashkësive dhe Këshillit të komunës. Gjegjësisht, komisioni mbajti takim me përfaqësues të organizatës joqeveritare rome, në kuadër të cilit u sollën rekomandime për kërkesën e organizatave joqeveritare rome të dorëzuar në komision. Rekomandimet iu dorëzuan këshillit të komunës dhe për ato diskutoi këshilli i komunës.